



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1382/24, Datë:12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. **Validohet** riakreditimi ndërkombëtar i Kolegjit Heimerer për periudhën **pesë (5) vjeçare** (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029) për programin e studimit:
 - *Infermieri BSc 180 ECTS me kuotën 200 student për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet IAL-së Heimerer që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet IAL-së Heimerer të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimet e bartësve bëhen me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

IAL-së Heimerer ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për validim të akreditimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi është marrë në bazë të certifikatave dhe dëshmimeve të ofruara, rreth akreditimit të këtij institucioni dhe rekomandimeve të dhëna nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit/akreditimit nga Agjencia EVALAG, e cila është anëtare e Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA).

Rekomandimi përfundimtar nga vlerësuesit ndërkombëtarë ishte që të bëhet akreditimi për periudhë gjashtë (6) vjeçare, por KShC duke u bazuar në faktin se legjislacioni vendor mundëson akreditimin vetëm tre (3) vjeçar dhe pesë (5) vjeçar, vendosi që ky program të akreditohet për periudhën **pesë (5) vjeçare** si në dispozitiv të këtij vendimi.

Faqe 1 nga 2

Kolegji Heimerer brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për validim të riakreditimit të programit të studimit si në paragrafin I të dispozitivit të këtij vendimi me bartësit e programit si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Infermieri BSc 180 ECTS</i>	Flaka Siqeca Blerim Hetemi Petrit Beqiri

Kërkesa dhe materialet e nevojshme për shqyrtim i janë dorëzuar me kohë KShC-së dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm për validim KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Periodha pesë vjeçare është kufizuar bazuar në nenin 19 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Heimerer dhe duke ju referuar Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe raporteve, certifikatave dhe dëshmime të ofruara për riakreditimin e këtij institucioni përkatësisht programit *Infermieri BSc 180 ECTS* nga Agjencia EVALAG e cila është anëtare e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit Heimerer;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë